

RREGULLORE

“PËR MARRËVESHJET ME RËNDËSI TË VOGËL ”

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHËSHME

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përjashtimi i atyre marrëveshjeve nga ndalimi të cilat nuk sjellin pasoja mbi konkurrencën në treg, dhe nuk përfshihen në fushën e zbatimit të nenit 4 të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”

Neni 2

Përkufizime

1. Në kuptim të kësaj rregulloreje , “ndërmarrje”, “palë në marrëveshje”, “shpërndarës”, “ofrues” dhe “blerës” përfshihen në konceptin e “ndërmarrjes së lidhur”

“Ndërmarrje të lidhura” janë ato ndërmarrje të cilat direkt ose indirekt

- kanë fuqinë të ushtrojnë më tepër sesa gjysmën e të drejtave të votës;
- Ka fuqinë të caktojë më tepër sesa gjysmën e anëtarëve të bordit mbikëqyrës, bordit menaxherial ose bordit ligjor të përfaqësuesve të ndërmarrjes; ose
- Ka fuqinë të menaxhojë veprimtarinë e ndërmarrjes.

Neni 3

Rregulla të përgjithshme

1. Neni 4 i Ligjit ndalon marrëveshjet ndërmjet ndërmarrjeve të cilat mund të kenë si objekt ose pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg.
2. Marrëveshjet ndërmjet ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, në shumë pak raste mund të ndikojnë në konkurrencën në treg.
3. Autoriteti, për marrëveshjet që plotësojnë kriteret e kësaj rregulloreje, nuk fillon procedurat hetimore.
4. Kjo rregullore gjithashtu aplikohet për vendimet e bashkimeve të ndërmarrjeve dhe për praktikat bashkërenduese.

KREU II

Marrëveshjet me rëndësi të vogël

Neni 4

Kuptimi i marrëveshjeve me rëndësi të vogël

1. Konsiderohen si marrëveshje që nuk kufizojnë ndjeshëm konkurrencën sipas kuptimit të nenit 4 të Ligjit :
 - a. N.q.s totali i pjesës së tregut që kanë palët në marrëveshje nuk tejkalon 10% të çdo një nga tregjet përkatëse të ndikuar nga marrëveshja, kur marrëveshja është lidhur ndërmjet ndërmarrjeve të cilat janë konkurrentë aktualë ose potencialë në çdo një nga këto tregje (marrëveshjet ndërmjet jo-konkurrentëve), ose
 - b. N.q.s pjesa e tregut e secilës palë në marrëveshje nuk tejkalon 15% të çdo një nga tregjet përkatëse të ndikuar nga marrëveshja kur ajo është lidhur ndërmjet ndërmarrjeve të cilat nuk janë konkurrentë aktualë ose potencialë në çdo një nga këto tregje (marrëveshje ndërmjet jo-konkurrentëve).

Në rast pamundësie të klasifikimit të marrëveshjes si marrëveshje ndërmjet konkurrentëve ose jo-konkurrentëve, atëherë është e aplikueshme zbatueshme pjesa prej 10 për qind e tregut .

2. Kur në një treg përkatës, konkurrenca është e kufizuar nga efekti kumulativ i marrëveshjes për shitjen e të mirave ose shërbimeve të ofruara nga ndërmarrje të ndryshme, pjesa e tregut sipas pikës 1 të këtij neni reduktohet në 5% si për marrëveshjet ndërmjet konkurrentëve ashtu edhe për marrëveshjet ndërmjet jo-konkurrentëve. Efekti pengues kumulativ është i pamundur të ekzistojë n.q.s më pak se 30% e tregut përkatës mbulohet nga marrëveshje paralele që kanë efekte të ngjashme.
3. Marrëveshjet nuk janë kufizuese për konkurrencën n.q.s pjesët e tregut nuk tejkalojnë pjesën prej 5, 10%, dhe 15% të vendosur sipas pikës 1 dhe 2 të këtij neni përgjatë dy viteve të njëpasnjëshme kalendarikë më shumë se 2 %.
4. Me qëllim llogaritjen e pjesës së tregut, është e nevojshme të përcaktohet tregu përkatës i cili përcaktohet bazuar në udhëzimin “Për përcaktimin e tregut përkatës”. Kjo konsiston në tregun përkatës të produktit dhe tregun përkatës gjeografik. Pjesët e tregut duhet të llogariten mbi bazën e vlerës së shitjeve ose kur është e përshtatshme të vlerës së blerjeve. N.q.s të dhënat në vlerë nuk janë të disponueshme përdoren vlerësimet bazuar në informacionet e tjera të vlefshme të tregut përfshirë të dhënat e vëllimit.

KREU III Dispozita të tjera

Neni 5

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë.